



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5 DHJETOR 2024, ora 22:30**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. DECEMBRA 2024. GODINE, 22:30 časova**

**DHJETOR - DECEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-324 për financimin e menaxhimit të resurseve yjore,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit, si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale.

Dnevni red

1. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-324 o finansiranju upravljanja vodnim resursima,
2. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-330 o centralnoj inspektoratu Zivotne sredine, vode, prirode, izgradnje kao i za zaštitu od zračenja i nuklearnu bezbednost,
3. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-325 o Centralnom inspektoratu za kulturno nasleđe,
4. Drugo razmatranje N/zakona br. 08/L-326 protiv negativnih pojava u sportu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-323 o izmeni i dopuni Zakona br. 08/L-168 o Specijalnom tuzilaštvu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E hapim këtë seancë, e cila e ka pesë ligje, të cilat janë proceduar me procedurë të përshpejtuar të trajtimit të projektligjeve. Me siguri, për shkak edhe të një udhëtimi në Bruksel që e kanë deputetët javën e ardhshme, ndoshta nuk mund të mbajmë seancë, pastaj u afrohemi festave të fundvitit dhe nuk dihet më.

Të nderuar deputetë,

Më duhet ta bëj një përjashtim. Deputeti që çohet në dymbëdhjetë të natës prej Bradashit dhe vjen në Kuvend të Kosovës, kjo është për t'u përshëndetur. Prandaj, ia japim fjalën.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë bashkë me kolegun tim Pal Lekaj po vijmë prej Novosellës së Gjakovës. Jo prej Bradashit. Pyetja e parë, a ia ka mësyre dikush Kosovës, Rusia a Kina? Çka jeni duke bërë?!

Ju lutem, kjo nuk ka asnjë arsyeshmëri. A jeni duke e ditur çka jeni duke bërë? Seriozisht, po ju pyes, a jeni duke e ditur çka jeni duke bërë? Qysh more seancë të jashtëzakonshme në pikë të natës pa kurrfarë arsye? Po, nuk ka as Kina, as Rusia, as luftë nuk ka, të sigurt jeni, mos u tutni. Prapë mblidheni, prapë mund t'i bëni 62 deputetë, a sa i keni. Prapë mblidheni, kjo nuk asnjë logjikë.

E vetmja arsye pse jemi sonte këtu, ne bashkë me Palin, është sinqerisht t'ju themi që kjo s'ka kurrë një logjikë, kurrë një argument. Është kontrabandim i ligjeve, d.t.th. shmangie me procedurë të shpejtë pa kurrfarë mundësie. Ne nuk ishim këtu. Ne e bëmë një veprim politik.

Dimal Basha, ti të shkosh të flesh, se ia ka nisur gjumi me të marrë. Seriozisht, këtë porosi deshëm ta përçojmë, edhe t'ju themi që kjo nuk ka asnjë kuptim. Ashtu siç e thashë në postim, është një kontrabandim dhe një puç parlamentar si shumicë. Po e përfundoj. Kaq e keni.

KRYETARI: E prej atje ke ardhur të na kallëzosh diçka që e lexuam në Facebook, në statusin aty që e ke shkruar?

Unë sapo e thashë që me siguri këto procedura i janë imponuar mazhorancës, se si duket javën e ardhme nuk i kemi kushtet të mbajmë seancën, pastaj shkojmë drejt festave të fundvitit dhe krejt këto ligje që janë vetëm në shqyrtim të parë që mbeten kthehen në zero procedurat. Kjo ka qenë një urgjencë ndoshta e mazhorancës për t'u koncentruar, sidomos këto ligjet që janë në shqyrtim të parë, pastaj me shmangie të kalohet edhe në shqyrtimin e dytë. Po ma merr mendja, logjika ka qenë kjo.

Kush dëshiron të flasë? I kemi vetëm votimet tash.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-324 për financimin e menaxhimit të resurseve ujore

Pra, Komisioni për Mjedis e ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar që këto klauzola të ligjit, pra nenet dhe amendamentet janë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian se këto nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve garanton që projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Znj. Pacolli-Dalipi, a dëshironi të thoni diçka për këtë projektligj?

FITORE PACOLLI-DALIPI: Në rregull është, kryetar. Procedojmë me votim.

KRYETARI: Përgatituni për votim!

A është mazhoranca e kompletuar?

Votojmë tash projektligjin në fjalë!

61 vota për, zero kundër, zero abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në lexim të dytë Projektligjin për financimin e menaxhimit të resurseve ujore.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-330 për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit, si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Besniku thoshte asgjë s'është rrezik. Bërthamore!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mjedis e ka shqyrtuar këtë projektligj, na ka rekomanduar ta miratojmë.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji në të vërtetë përmban implikime buxhetore shtesë, por të cilat janë të përballueshme për buxhetin tonë.

Komisioni për Legjislacion nuk ka vërejtur ndonjë shpërputhje mes Kushtetutës dhe ligjeve tona e këtij projektligji.

Komisioni për Integritet Evropian na ka thënë se këto nene të projektligjit nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar dhe ka garantuar se ato nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Znj. Pacolli-Dalipi?

Atëherë, nëse mazhoranca i ka të gjithë deputetët e nevojshëm, e hedhim në votim këtë projektligj. Përgatituni për votim, votojmë tash!

61 vota për, zero kundër, zero abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për Inspektoratin Qendror të mjedisit.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-325 për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsimit na ka kërkuar ta miratojmë këtë projektligj.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion se ky ligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se ky material nuk trajtohet në veçanti nga legjislacioni i BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kryetari i komisionit, Gola, na propozon ta hedhim në votim.

Përgatituni për votim! Votojmë tash!

Vetëm 60 deputetë.

E provojmë edhe herën e dytë. Me sigurisht, dikush nuk ka votuar, pa qëllim.

Votojmë tash!

61 vota për, zero kundër, zero abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi projektligjin në fjalë, është pra Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore.

Tash e kemi projektligjin e parafundit për sonte:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-326 kundër dukurive negative në sport

Të nderuar deputetë,
Komisioni për Arsim ka vlerësuar që ky projektligj duhet të miratohet në Kuvend.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
Komisioni për Legjislacion na ka garantuar se është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm, pasi e kanë shqyrtuar atë.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se ky projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat e tyre.

Gola?

E hedhim në votim.

Përgatituni për votim! Votojmë tash!

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Projektligjin kundër dukurive negative në sport.

Projektligji i fundit për sonte është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-323 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale

Komisioni për Legjislacion na ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji në fjalë nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Adnan Rrustemi, jeni propozues së bashku me deputetët.

Mund të procedojmë me votimin?

Projektligji i fundit. Përgatituni për votim! Votojmë tash!

61 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për Prokurorinë Speciale.

Një fjalë? Urdhëro, lirisht!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Mirëmbërëma, të gjithëve!

Në veçanti deputetëve të opozitës. Zoti Lekaj, urime dhe me fat Nata e Shën Kollit, keni ardhur prej festës në Novosellë, bashkë me z. Tahiri. Shfrytëzoj rastin t'u uroj Natën e Shën Kollit të gjithë atyre që e festojnë sonte. Ndryshe, përderisa ju keni festuar, ne kemi qenë duke punuar. Një rezyme dhe një falënderim nga zemra për krejt ju deputetët sot për dymbëdhjetë orët e fundit që keni qëndruar në sallë stoikisht.

Sot, bashkë katërbëdhjetë orë, dakord. Sot bashkë kemi miratuar, që ta dini, tetëmbëdhjetë ligje, kemi kompletuar tri borde, atë të KOSTT-it, KSHC-në dhe Trustin. Kemi votuar Rregulloren e Komisionarit të Forcës dhe Sigurisë të Kosovës, kemi votuar pesë raporte, një të ndërmarrjeve publike, dy të KPSHC-së dhe dy të mbikëqyrjes së ligjeve nga Komisionit për Shëndetësi.

Ju falënderoj nga zemra! Faleminderit, kryetar, faleminderit, nënkryetare, ju priftë e mbara, natën e mirë!

Me këtë, mund të themi që kemi pasur një ditë shumë të suksesshme, edhe një natë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe Administratës së Kuvendi që qëndruan deri në orët e vona me ne. I mbyllim punimet e kësaj seance. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*